



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:054418

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06232278

KA.nr.347/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë adresa rruga “Zija Shemsiu” numër 34 përfaqësuar sipas autorizimit nga avokat Z.Isamedin Dedinca nga Prishtina kundër të paditurve 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit (tutje referuar OSHP) me seli në Prishtinë përfaqësuar sipas autorizimit nga Znj. Arlinda Morina, 2. Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (tutje referuar ASHNA) me seli në Lipjan, për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr. 209/20 të datës 24.04.2020 pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 09.09.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit me autorizim të palës paditëse dhe të përfaqësuesve me autorizim të palëve së paditura, më datë 20.09.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET në tërësi** kërkesëpadia e paditësit Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë kundër të paditurve 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, 2. Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror me seli në Lipjan, me çka kërkuar të anulohet vendimi PSH.nr. 209/20 të datës 24.04.2020, të OSHP-së si të kundërligjshëm, me propozim që të detyrohet e paditura e dytë Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror me seli në Lipjan, që paditësit t’ia kompensoj dëmin që i është shkaktuar në lartësinë prej 7,790.00 euro me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë në Gjykatë, e deri në pagesën definitive në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, **si e pa bazuar.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 19.05.2020, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.858/2020, kundër të paditurve 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit (tutje referuar OSHP) me seli në Prishtinë, 2. Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror me seli në Lipjan, për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr. 209/20 i datës 24.04.2020, me propozim që të që të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit IPKO Telecommunications LLC si e bazuar, të anulohet vendimi i të paditurës së parë OSHP me nr. 209/2020 i datës 27.04.2020 si i kundërligjshëm, të detyrohet i padituri i dytë Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror me seli në Lipjan, që paditësit t'ia kompensoj dëmin që i është shkaktuar në lartësinë prej 7,790.00 euro me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë në Gjykatë, e deri në pagesën definitive në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA nr. 347/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik konform nenit 41 të LKA-së më datë 09.09.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës paditëse Z.Isamedin Dedinca sipas autorizimit të datës 02.12.2019 dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës së paditurës së parë Znj.Arlinda Morina sipas autorizimit të datës 09.09.2024 ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të paditurës së dytë të ftuar në mënyrë të rregullt, i cili ftesën për në seancë e ka pranuar më datë 28.08.2024.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se më datë 09.03.2020 Autoriteti Kontraktues (tutje referuar AK), Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në procedurë të hapur ka publikuar Njoftimin për Kontratë me titull “Linja e huazuar optike me Golesh”, me numër të prokurimit 254-20-767-2-3-6, me numër të brendshëm ASHNA/20/00/236. Sipas tij më datë 25.03.2020 Operatori Ekonomik “Telekomi i Kosovës”, Sha, ka parashtruar ankesë te i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit (tutje OSHP), kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Linja e huazuar optike me Golesh”, me numër të prokurimit 254-20-767-2-3-6, me numër të brendshëm ASHNA/20/00/236”, me arsyetim se AK ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së respektivisht ka vepruar në kundërshtim me nenin 9.4 të Ligjit për Prokurimin Publik.
5. Ka shtuar se OE Telekomi i Kosovës Sha., fare nuk ka marr pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, ky i fundit pretendon se së asnjë rast Institucionet Publike nuk duhet të hapin tender publik sepse për çdo shërbim që e ofron OE “Telekomi i Kosovës”, institucionet publike duhet të lidhin kontratë me Telekomin e Kosovës”, duke e përjashtuar nga procedurat e prokurimit.
6. Ka pretenduar se vendimi i të paditurit i kontestuar me padi është i kundërligjshëm për faktin se si vendim është i marrë duke u bazuar në rastet e mëparshme me interpretim të gabuar të dispozitës së nenit 9.4 të Ligjit për Prokurimin Publik (tutje LPP), duke e anuluar një procedurë të prokurimit publik e cila ishte duke u zhvilluar konform dispozitave të LPP-së. Vendimi i kundërshtuar është nxjerr në kundërshtim edhe me nenin 7 të LPP-së i cili përcakton që të gjithë OE-të do të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese nuk do të ekzekutohet asnjë aktivitet i prokurimit i cili do të reduktoj apo eliminoj konkurrencën midis operatorëve apo që diskriminon në dëm ose në të mirë një apo më shumë OE, andaj i padituri OSHP në kundërshtim të plotë të kësaj dispozite ligjore Telekomin e Kosovës Sha, nuk e trajton sikur të gjithë OE-të në mënyrë të barabartë, por në mënyrë të kundërligjshme ia mundëson lidhjen e kontratave me autoritetet publike. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpapia e paditësit IPKO Telecommunications LLC si e bazuar, të anulohet vendimi i të paditurës së parë OSHP me nr. 209/2020 i datës 27.04.2020 si i kundërligjshëm, të detyrohet i padituri i dytë Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror me seli në Lipjan, që

paditësit t'ia kompensoj dëmin që i është shkaktuar në lartësinë prej 7,790.00 euro me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë në Gjykatë, e deri në pagesën definitive në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Kundërshtimet e të paditurës së parë OSHP

7. Përfaqësuesi i të paditurës në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi sipas parashtrësës së datës 11.01.2024, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe një fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë vendimit të kundërshtuar me padi, AK nuk ka vepruar në harmoni me nenin 9.4 të LPP-së dhe nenit 7 po ashtu ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A par.2.7.9 dhe 14 të LPP-së. Vendimi i kundërshtuar me padi është i bazuar në vendimin e fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 05/21 të datës 02.04.2020 ku sipas këtij vendimi është aprovuar propozimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit për Prokurimin Publik për Shërbimet Telekomunikuese që ofron “Telekomi i Kosovës”, Sha., si shërbime me rendësi të veçantë shtetërore në harmoni me nenin 3.1 dhe 9.4 të LPP-së. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit ndërsa të vërtetohet si i ligjshëm vendimi me nr. PSH.nr. 209/20 i datës 27.04.2020.

Kundërshtimet e të paditurës së dytë Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

8. Përfaqësuesi i të paditurës së dytë në pretendimet e dhëna përmes përgjigjes në padi sipas parashtrësës së datës 24.05.2024, ka deklaruar se kërkesëpadija e paditësit është në tërësi si e pa bazuar për faktin se në pajtim me vendimin e OSHP-së Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror më datë 04.05.2020 ka lëshuar njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me numër 254-20-767-2-3-6 duke theksuar se më datë 22.06.2020 Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ka bërë ftesë për negociata për procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë të aktivitetit “Linja e huazuar optike në Golesh’ por që në mungesë të interesimit të Telekomit të Kosovës përsëri ka dështuar. Në mungesë të ofertës, më datë 07.07.2020 Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror vendos për anulimin e procedurës së prokurimit me nr. 254-20-2679-2-3-5 përkatësisht ASHNA 20/008/235.

9. Ka shtuar se bazuar në kërkesën e paditësit që të sigurohet kontrata e AK-së ASHNA për aktivitetin “Linja e huazuar optike në Golesh” me numër 254-20-767-2-3-6 duke informuar se kjo kontratë nuk është lidhur asnjëherë pasi që OE Telekomit i Kosovës nuk i ishte përgjigjet këtyre aktivitetëve. Padia e paditësit për dëmshpërblim për fitimin e humbur është e pa bazuar, pasi që aktiviteti i prokurimit me nr. 254-20-767-2-3-6 është anuluar nga ana e OSHP-së aktivitet që nuk është ri tenderuar asnjëherë nga ana e Autoritetit Kontraktues – Agjencisë të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, si dhe kanë kontestuar legjitimitetin pasiv për të qenë palë në procedurë pasi që OSHP është organ vendimmarrës për procedurat dhe ankesat në prokurimin publik. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit IPKO Telecommunications LLC ndaj të paditurit të dytë Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) pasi që veprimet kontestuese kanë ardhur nga e paditura e parë OSHP.

Provat e administruara

10. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Dosja e tenderit me numër të prokurimit 254-20-767-2-3-6 me datë 09.03.2020 me titull linja e huazuar optike me Golesh me numër të brendshëm të prokurimit ASHNA/20/008/236, Vendim i panelit shqyrtues të OSHP-së me numër Psh.209/20 të datës 27.04.2020, Njoftim për aktivitetin e prokurimit me datë 04.05.2020. Nga provat e administruara vërtetohet këtë gjendje faktike:
11. Nga Dosja e tenderit 254-20-767-2-3-6 me datë 09.03.2020 me titull “Linja e huazuar optike me Golesh” me numër të prokurimit 254-20-767-2-3-6, me numër të brendshëm ASHNA/20/008/236”, AK Agjencia e shërbimeve të navigacionit ajror ka njoftuar OE-të e interesuar për aplikim në aktivitetin e prokurimit me “Linja e huazuar optike me Golesh” me numër të prokurimit 254-20-767-2-3-6, me numër të brendshëm ASHNA/20/008/236” lidhur me pjesët e dosjes së tenderit dhe anekset e saj, kërkesat specifikimet, duke i njoftuar se kuotimi i çmimit duhet të dorëzohet para datës 24.03.2020.

12. Nga Vendimi i kundërshtuar PSH.nr. 209/20 i datës 24.04.2020, Paneli Shqyrtues i OSHP-së në pikën I të vendimin e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e OE “Telekomi i Kosovës” Sh.a., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Linja e huazuar optike me Golesh” me numër të prokurimit 254-20-767-2-3-6, me numër të brendshëm ASHNA/20/008/236” iniciuar nga AK Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ndërsa në pikën II të këtij vendimi e ka anuluar njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit, me arsyetim se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A par. 2,7,9 dhe 14 të LPP-së sepse AK nuk e ka pezulluar fare këtë aktivitet të prokurimit edhe pas kërkesës për rishqyrtim nga OE si dhe nuk ka respektuar nenin 109 par.2 të LPP-së pasi që AK nuk ka vazhduar afatin për dorëzimin e ofertave për pjesëmarrësit në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji”. Paneli shqyrtues ka sqaruar se ka vepruar në bazë të Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (tutje referuar si KRPP),që ka lëshuar një interpretim në lidhje me pretendimin e OE ankues për mos respektim të nenit 9.4 të LPP-së nga Autoritetet Kontraktuese ku ka sqaruar se “Nëse një AK është autoritet publik autoriteti i tillë duhet të marr masa të arsyeshme për tu siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik, dhe është bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr./ 05/21 të datës 02.04.2020 vendim që përjashton LPP-në për shërbimet telekomunikuese që ofron “Telekomi i Kosovës” SH.A, si shërbime me rëndësi të veçantë shtetërore, në harmoni me nenin 3.1 dhe 9.4 të LPP-së.

13. Nga Njoftimi për kontratë me datë 04.05.2020, AK Agjencia e shërbimeve të navigacionit ajror ka njoftuar mbi anulimin e aktivitet të prokurimit me titull “Linja e huazuar optike me Golesh” me numër të prokurimit 254-20-767-2-3-6, me numër të brendshëm ASHNA/20/008/236”, me arsyetim se anulimi i procedurës së prokurimit bëhet për shkak të një dispozitë ligjore e Ligjit për Prokurimin Publik.

Vlerësimi i gjykatës

14. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padë nga paditësi, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

15. Gjykata vlerëson se Paneli Shqyrtues i OSHP-së, gjatë nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar me padi PSH.nr. 209/20 i datës 24.04.2020, e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e OE “Telekomi i Kosovës” Sh.a., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Linja e huazuar optike me Golesh” me numër të prokurimit 254-20-767-2-3-6, me numër të brendshëm ASHNA/20/008/236” iniciuar nga AK Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, duke u bazuar në interpretimin e Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP), që ka lëshuar në lidhje me pretendimin e për mos respektim të nenit 9.4 të LPP-së nga Autoritetet Kontraktuese ku ka sqaruar se “Nëse një AK është autoritet publik autoriteti i tillë duhet të marr masa të arsyeshme për tu siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr./ 05/21 të datës 02.04.2020 vendim që përjashton LPP-në për shërbimet telekomunikuese që ofron “Telekomi i Kosovës” SH.A, si shërbime me rëndësi të veçantë shtetërore, në harmoni me nenin 3.1 dhe 9.4 të LPP-së.
16. Sipas vendimit nr. 05/21 të datës 02.04.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me të cilin “Telekomi i Kosovës” është përjashtuar nga procedura e prokurimit. Neni 3 par. 1 të LPP-së përcakton detyrimin për OSHP-në dhe AK që *“Pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij ligji, autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë që të veprojë në përputhje me ndonjë procedurë të veçantë të prokurimit apo të respektoj dispozitat e këtij ligji mbi transparencën gjer në shkallën kur, përputhshmëria dhe respektimi do të kompromitonin sekretin e ligjshëm ose interesat e sigurisë gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit të rëndësishme për dhënien e një kontrate publike për të cilën Qeveria është pajtuar që ta përjashtojë nga fushëveprimi i këtij ligji sepse (i) ekzekutimi i kontratës në fjalë, sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë, kërkon përdorimin e masave të veçanta të sigurisë, ose (ii) Qeveria është pajtuar që ta klasifikojë lëndën e kontratës në fjalë si sekret.* Prandaj gjykata vlerëson se OSHP –sipas dispozitave ligjore ka vepruar sipas vendimit të Qeverisë 5/21 të datës 02.04.2020.
17. Gjykata vlerëson se paditësi përmes padisë ka kërkuar anulimin e vendimit PSH.nr. 209/20 i datës 24.04.2020, Paneli Shqyrtues i OSHP-së dhe nuk ka kërkuar vlerësimin e ligjshmërisë të vendimit të Qeverisë me nr. 05/21 të datës 02.04.2020, në bazë të cilin është nxjerr vendimi, i cili ka qenë në fuqi në kohën e marrjes së vendimit të kundërshtuar

i OSHP-së, prandaj gjykata nuk u lëshuar në vlerësimin e ligjshmërisë së këtij vendim, në bazë të cilit është marrë vendimi i kundërshtuar me padi.

18. Vendimi i Qeverisë me nr. 05/21 të datës 02.04.2020, është shfuqizuar me Vendimin Nr. 05/34 të datës 07.10.2020. Sipas, Neni 5 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, 1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. 2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.
19. Prandaj, gjykata vlerëson se në kohën e marrjes së Vendimit të kundërshtuar PSH.Nr.209/20 me datë24.04.2020nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, ishte në fuqi Vendimi i Qeverisë me nr. 05/21 të datës 02.04.2020, ligjshmëria e të cilit nuk është kontestuar. Duke pas parasysh që Vendimi 05/21 të datës 02.04.2020 ishte shfuqizuar me Vendimin Nr. 05/34 të datës 07.10.2020, deri në momentin e shfuqizimit i njëjti ka krijuar pasoja juridike, të cilat ndërprerën vetëm pas shfuqizimit, prandaj konsiderohet se vendimi i kundërshtuar PSH.Nr.209/20 me datë24.04.2020nga Paneli Shqyrtues i OSHP është marrë në bazë të një aktit në ligjor të vlefshëm në kohën e zbatimit.
20. Kërkesa e paditësit për kompensim të fitimit të humbur për mos dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, është e pabazuar në kuptim të nenit 46. paragrafi 4 të LKA-së ku përcaktohet *se kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative, sepse në këtë rast nuk u anulua akti administrativ i kundërshtuar.*
21. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzime procedurale shpenzimet procedurale u more në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.347/22, datë 20.09.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.